



Përmbledhje
e Politikave

**Pajtimi
përmes
Procesit
të Berlinit:**

roli i KOMRA-s



Koalicioni për KOMRA-n



PAJTIMI PËRMES PROCESIT TË BERLINIT: roli i KOMRA-s

Përmbledhje e Politikave

Nëntor 2017.

BOTUES:

Koalicioni për KOMRA-n

REDAKTORE:

Ana Marjanoviq Rudan

AUTORË:

**Natasha Kandiç
Ana Marjanoviq Rudan
dr Igor Novakoviç
dr Jelica Miniç
Sven Milekiç**

PËRKTHIMI:

Besim Rexhaj

DIZAJNI:

Todor Cvetkoviç

SHTYPI:

Publikum

PËRMBAJTJA

Parathënie: Procesi i pajtimit dhe KOMRA 4

Rekomandim 5

- 1 Procesi i Berlinit si Kornizë për nënshkrimin e Marrëveshjes mbi KOMRA-n 6
- 2 Përse pajtimi në Ballkanin Perëndimor është i rëndësishëm për sigurinë e rajonit dhe të Bashkimit Evropian? 10
- 3 Përse pajtimi në Ballkanin Perëndimor është i rëndësishëm për suksesin e agjendës ekonomike të Procesit të Berlinit? 14
- 4 KOMRA si kusht për bashkëpunimin efikas të të rinjve, që çon drejt pajtimit 18

PARATHËNIE: PROCES I PAJTIMIT DHE KOMRA

Natasha Kandiq'

Konfliktet në territorin e ish Jugosllavisë kanë shkaktuar më së shumti viktimat në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Me gjithë përparimin në demokratizimin e shoqërive post-jugosllave, anëtarësimin e tyre në Këshillin e Evropës dhe në Bashkimin Evropian, marrëdhëniet në rajon edhe më tutje i ngarkon trashëgimia e luftës. Prosesi i pajtimit shoqëror, si parakusht thelbësor i integritetit brenda rajonit, nuk ka përfunduar dhe as që thelbësisht do të përparojë pa konstatimin e fakteve mbi pasojën më të dhembshme të konfliktit – krimet e luftës dhe viktimat në lidhje me luftërat².

Një nga mekanizmat thelbësor të drejtësisë tranzicionale, në kuadër të së cilës zhvillohet edhe procesi i pajtimit, është konstatimi i fakteve nga ana e Komisionit të përbashkët të palëve të dikurshme në konflikt në lidhje me krimet e luftës dhe viktimat, të cilat tash e 25 vite i ngarkojnë marrëdhëniet midis shoqërive në Ballkan. Konstatimi rajonal i fakteve (zbulimi dhe paraqitja e së vërtetës) e ka për qëllim që t'i pamundësojë manipulimet shoqërore politike dhe që t'i parandalojë interpretimet, të cilat e rrezikojnë lidhjen dhe bashkëpunimin. Konstatimi i fakteve e ngushton prodhimin e narrativave zyrtare, që mobilizojnë politikën nacionaliste dhe me këtë e lehtëson afrimin reciprok brenda rajonit dhe afrimin e tij në Bashkimin e Evropian!

Me pajtimin rajonal si objektiv, në vitin 2008, organizatat e shoqërisë civile nga e tërë ish Jugosllavia e kanë themeluar koalicionin rajonal, i cili sot tubon mbi 2000 organizata dhe individë. Në kuadër të tij, është filluar nisma për themelimin e Komisionit Rajonal për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në hapësirën e ish RFS të Jugosllavisë (KOMRA). Me nënshkrimet e tyre, iniciativën e kanë përkrahur mbi 550.000 qytetarë nga i tërë rajoni, kurse pas procesit inkluziv konsultativ katërvjeçar (gjatë të cilit në 128 debate kanë marrë pjesë 6700 përfaqësues të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe organizatat për të drejtat e njeriut, familjet e personave të pagjetur, dhe të vrarë, refugjatët, veteranët e luftës, juristët, artistët, shkrytarët, gazetarët dhe intelektualët e tjerë shoqërisht të angazhuar dhe qytetarët

1 Autorja është koordinatore e Koalicionit për KOMRA-n dhe themeluese e Fondit për të Drejtën Humanitare.

2 Mbi përmasat e nevojës për konstatimin e fakteve flet e dhëna në vijim: në lidhje me luftërat në hapësirën e ish RSF të Jugosllavisë janë vrarë rreth 130.000 njerëz, në periudhën prej datës 1. 1. 1991. deri në datën 31. 12. 2001. Deri në muajin qershor të vitit 2017, Koalicioni për KOMRA-n ka identifikuar 23.000 viktimat në lidhje me luftërat e viteve nëntëdhjetë dhe i ka konstatuar rrethanat e vdekjes së tyre, derisa Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ) ka konstatuar identitetin e rreth 18.000 viktimitave të krimeve të luftës.

nga hapësira e ish RSFJ-së), janë formuluar objektivat, kompetenca, kohëzgjatja dhe procedurat e punës së komisionit të ardhshëm. Mbi Këtë bazë, versionin përfundimtar të Projekt Statutit të KOMRA-s së ardhshme e kanë harmonizuar të dërguarit special të kryetarëve të vendeve post-jugosllave dhe Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Megjithëkëtë, me qëllim që KOMRA drejtpërdrejtë t'i kontribuojë pajtimit, vet nisma duhet të marr vulën shtetërore. Së pari, trashëgimtarët e ish RSF të Jugosllavisë duhet të nënshkruajnë Marrëveshjen ndërshtetërore mbi themelimin e KOMRA-s. Me këtë qëllim, në lidhje me mbajtjen e samitit në kuadër të procesit të Berlinit në Triest në muajin korrik të vitit 2017, 50.000 qytetarë të Sarajevës, Banja Llukës, Prishtinës, Beogradit dhe Zagrebit me nënshkrimet e tyre e kanë përkrahur propozimin e Koalicionit për KOMRA-n që procesi i Berlinit, si forumi më i rëndësishëm politik për bashkëpunimin rajonal, të jetë platformë, në kuadër të së cilës do të themelohet ky Komision ndërqeveritar.

Procesi i Berlinit ka futur një energji të re në bashkëpunimin rajonal, i ka dhënë një nxitje të fuqishme dhe i ka iniciuar nismat konkrete. Megjithëkëtë, në planin e pajtimit nuk ka pasur përparim, me çka është ruajtur hapësira për ringjalljen e tensioneve, të cilat e rrezikojnë bashkëpunimin në rajon dhe evropianizimin e tij. Për këtë arsye, Koalicioni për KOMRA-n e propozon themelimin e këtij komisioni ndërqeveritar në samitin e ardhshëm në vitin 2018.

REKOMANDIM

Me qëllim të përparimit të procesit të pajtimit rajonal, si kusht i domosdoshëm i bashkëpunimit dhe i sigurisë në Ballkanin Perëndimor si dhe i inkuadrimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, trashëgimtarët e ish RSF të Jugosllavisë duhet ta nënshkruajnë Marrëveshjen mbi themelimin e KOMRA-s (Komisioni për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të drejtave të njeriut në territorin e RSFJ-së nga data 1 janar e vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001) në takimin e ardhshëm në kuadër të serisë së samiteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor („Procesi i Berlinit”) në vitin 2018, kurse pas kësaj, pa zvarritje, duhet të ndërmarrin hapa konkret për themelimin e KOMRA-s në pajtim me Projekt Statutin e KOMRA-s.

1

PROCESI I BERLINIT SI KORNIZË PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES MBI KOMRA-N

Ana Marjanoviç Rudan³

Seria e samiteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, e njohur edhe si Procesi i Berlinit, ka filluar në vitin 2014 si një platformë katërvjeçare për nxitjen e bashkëpunimit midis shteteve në rajon dhe integrimin e tyre në Bashkimin Evropian me anë të përkrahjes së Komisionit Evropian, institucioneve ndërkombëtare financiare dhe shteteve anëtare të përfshira në proces⁴. Pos kësaj, në kohën e fillimit të procesit të Berlinit, roli i tij ka qenë që të tejkalonte hendekun në marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor, që është shfaqur në lidhje me degradimin institucional dhe politik të çështjes së zgjerimit nga ana e vet Bashkimit Evropian si dhe që, në momentin kur Evropa është ballafaquar me krizën shumëdimensionale, të inkurajojë orientimin evropian të shteteve të rajonit.

Procesi i Berlinit që nga fillimi është menduar si një instrument për nxitjen e reformave, të cilat shtetet e rajonit duhet t'i zbatojnë në kontekstin e pranimit në Bashkimin Evropian, nëpërmjet nismave dhe projekteve në fushat e rëndësishme për rajonin si tërësi. Në samitin e parë në Berlin, aty ku edhe ky proces ka filluar, kancelarja gjermane Angela Merkel në Deklaratën e kryesueses ka vënë në spikamë se seria e samiteve të Ballkanit Perëndimor duhet të sigurojë kornizën për „përparimin e vërtetë” në zgjidhjen e çështjeve bilaterale, çështjeve të pajtimit, të përparimit të bashkëpunimit ekonomik dhe në vënien e themeleve për një rritje të qëndrueshme – me çka janë shënjuar edhe objektivat konkrete të këtij procesi.

Ideja ka qenë që projektet në kuadër të procesit të Berlinit t'i përparojnë tri dimensione të lidhjes në Ballkanin Perëndimor: ekonomik, social dhe politik. Secili shtet nikoqir i samiteve vjetore e ka drejtuar procesin me shtimin e “vulës” së vet, duke e zgjeruar regjistrin e “detyrave” për shtetet e rajonit në realizimin e objektivave të përgjithshme të vendosura në Berlin. Kështu, në kuadër të Procesit të Berlinit, në samitet vjetore

³ Autorja është bashkëpunëtare e nismës *Western Balkans 6 Advocacy Group* dhe këshilltare në *Praxis Development Consulting-u*.

⁴ Sot ato janë Austria, Franca, Italia, Kroacia, Gjermania, Sllovenia dhe Britania e Madhe.

dhe në ngjarjet përcjellëse midis tyre⁵ janë hapur temat e lidhjes rajonale në fushat e transportit, energjetikës, ekonomisë, digjitalizimit, mbrojtjes së ambientit jetësor, bashkëpunimit të rinjve, bashkëpunimit shkencor etj., si dhe, vërtet, dukshëm më rrallë dhe sipas rregullit jashtë takimit qendror, temat e sundimit të ligjit dhe sigurisë së rajonit, çështjet bilaterale dhe të pajtimit.

Në kuadër të këtyre temave, më së shumti projekte konkrete dhe nisma janë filluar në dimensionin e lidhjes ekonomike dhe atë në fushën e lidhjeve të infrastrukturave të transportit dhe atyre energjetike, në mënyrë që, pas takimit të Parisit, fokusi të zgjerohet edhe në lidhjen e ekonomive e pastaj edhe në fushën e digjitalizimit dhe bashkëpunimit në shkencë. Dukshëm më pak projekte janë nisur në dimensionin social të lidhjes rajonale, në kuadër të së cilës, krahas shumë zvarritjeve, janë themeluar Zyra Rajonale për bashkëpunim të rinjve, sipas modelit francezo-gjerman në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe fondi i Ballkanit Perëndimor sipas modelit të Vishegradit. Dimensionit të lidhjes politike, ku është intensifikuar dialogu i Beogradit dhe Tiranës, kurse në kuadër të samitit vjenez, sipas nismës së shoqërisë civile, është nënshkruar Deklarata mbi çështjet bilaterale – më së paku i është kushtuar vëmendje.

Në vitin e fundit të Procesit të Berlinit shihet vazhdimi i tij përmes „Berlin plus” si dhe ambiciet e shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian për t’u inkuadruar në këtë nismë, dhe përmbledhen rezultatet e deritashme si dhe shqyrtohet e ardhmja. Ekspertët nga rajoni dhe Bashkimi Evropian me të drejtë tërheqin vërejtjen se vëmendja dominuese, e cila drejtohet drejt zhvillimit të infrastrukturës dhe ekonomisë (për të cilat, përndryshe, ekzistojnë edhe sfida në pikëpamje të financave) nuk çon në mënyrë automatike deri te përparimi i sigurisë, sundimi i ligjit, zgjidhja e çështjeve bilaterale dhe çështja e pajtimit, që përbëjnë probleme themelore të rajonit, dhe se ka qenë naivitet për të pritur këtë. Shprehet pakënaqësia me mungesën e masave për zbatimin e marrëveshjes së samitit, kurse edhe kanë munguar mekanizmat për përcjelljen e përparimit. Nuk shfrytëzohet shansi që përmes komunikimit më të mirë të inspirohet publiku për të përkrahur reformat e nevojshme për evropianizimin e rajonit. Për më tepër, sot duket se „Berlin Plus” do të jetë vetëm vazhdim i praktikës së deritashme dhe se kjo platformë nuk do të shfrytëzohet për „ripolitizim” të integritetit të rajonit në Bashkimin Evropian, që liderët e Bashkimit Evropian do t’i motivonte për „garim” në përparimin e sundimit të ligjit, në siguri, në zgjidhjen e çështjeve bilaterale dhe në procesin e pajtimit.

⁵ Gjë që ia mundësoi shoqërisë civile, mediave, të rinjve dhe asociacioneve biznesore të marrin pjesë në këtë proces.

Pajtimi, si proces i vendosjes së marrëdhënieve paqësore dhe miqësore, është bazë e sigurisë rajonale dhe garant i qëndrueshmërisë së bashkëpunimit rajonal – arsye kjo për të cilën në Berlin është shënjuar edhe si një nga katër objektivat e procesit. Megjithatë, për shkak të mbizotërimit të „apoliticitetit” të Procesit të Berlinit, çështja e pajtimit deri më tash nuk ka qenë temë e veçantë e takimeve të kreut. Kjo, duke qenë se nga viti në vit pesha e tij theksohet në dokumentet zyrtare, është e çuditshme – pas asaj berlineze - Deklarata e Kryesuesit nga Vjena (2015) e vë në spikamë shpërputhjen midis proliferimit të strukturave për bashkëpunimin rajonal me hapat konkret të liderëve të Ballkanit Perëndimor në drejtim të pajtimit të qëndrueshëm. Pajtimin e përmend edhe Deklarata e Parisit, në të cilën lexojmë se është një nga objektivat themelore të Zyrës Rajonale për bashkëpunimin me të Rinjtë (me çka Procesi vetëm në mënyrë të tërthortë është marrë me pajtimin). Deklarata e Triestës e thekson lidhjen e bashkëpunimit rajonal dhe të pajtimit dhe, që përbënë shenjë e parë të përparimit konkret, në të për herë të parë njihet nisma për themelimin e Komisionit rajonal, ndërqeveritarë për konstatimin e fakteve – KOMRA-s⁶. Në takimin e Triestës, pajtimi dhe nisma për themelimin e Komisionit ndërqeveritarë si mekanizëm kyç i tij hyjnë në agjendën e samitit të Procesit të Berlinit “përmes dyerve të vogla”, në kuadër të Forumit të shoqërisë civile.

Procesi i Berlinit, me gjithë mungesat e tij, „i ka dhënë frymë” bashkëpunimit rajonal në atë mënyrë, e cila nuk i ka shkuar përdore asnjërës prej mbi shtatëdhjetë nismave që lidhin akterët shtetëror e joshtetëror të zhvillimit shoqëror në rajon. Ai ia ka dalë që në të njëjtën tryezë, prej viti në vit, të sjellë liderët politik të rajonit, por edhe të mobilizojë nismat rajonale dhe të vendos, deri tash, platformën më të gjerë për bashkëpunimin rajonal të shoqërisë civile, të rinjve, subjekteve ekonomike dhe akterëve të tjerë joshtetëror. Për këtë arsye, në periudhën që vjen, me qëllim që Procesi i Berlinit të sjellë ndryshime edhe në fushat themelore, ai duhet të theksojë dimensionin politik të lidhjes rajonale dhe të nxis zgjidhjen e çështjes së sundimit të ligjit, të sigurisë, të çështjeve bilaterale dhe të çështjeve të pajtimit – që janë kushtet thelbësore për bashkëpunimin rajonal dhe afrimin e rajonit drejt Evropës.

Kronologjikisht, ndoshta e para në mesin e atyre kushteve, kurse gjithsesi një nga objektivat më eksplisit të Procesit të Berlinit, është çështja e pajtimit. Mekanizmi i tij kyç, krahas gjykimeve për krimet e luftës, përbënë konstatimin ndërshtetëror të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në lidhje me

6 Emri i plotë: Komisioni Rajonal për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të Kryera në territorin e ish RSFJ-së nga data 1 janar e vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001.

luftërat e viteve nëntëdhjetë, si dhe Konstatimin e fateve individuale; sepse, nëse atë, ashtu siç e propozon Koalicioni për KOMRA-n, do ta zbatonte komisioni ndërqeveritar – do të pamundësoheshin manipulimet me shifrat e viktimave dhe do të parandaloheshin që kjo çështje të mbetet rrezik i përhershëm për secilin bashkëpunim në rajon.

Duke qenë i vetmi nga objektivat e Procesit të Berlinit në lidhje me të cilin deri tash nuk ka pasur përparim konkret, pajtimi nuk do të guxonte të mbetet mbrapa në agjendën e samitit të ardhshëm në Britaninë e Madhe. Jo vetëm që kjo do t'i kontribuonte lidhjes politike, por nënshkrimi i marrëveshjes ndërshtetërore mbi themelimin e komisionit rajonal për konstatimin e fakteve – KOMRA, do të ishte masë e rëndësishme dhe konkrete në procesin e pajtimit në rajon.

2

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM PAJTIMI NË BALLKANIN PERËNDIMOR PËR SIGURINË E RAJONIT DHE TË BASHKIMIT EVROPIAN?

dr Igor Novaković⁷

Thelbi i projektit evropian, përmes të gjitha metamorfozave të tij, është sigurimi i paqes dhe i sigurisë në kontinentin evropian. Ballkani Perëndimor nuk është i ndryshëm me asgjë – procesi i integritimeve evropiane duhet të sjellë stabilizimin dhe zhvillimin më se të nevojshëm si dhe integrimin institucional reciprok dhe atë të vlerave të shteteve të rajonit dhe të qytetarëve të tyre përmes institucioneve, të drejtës dhe vlerave të Bashkimit Evropian. Që nga fillimi i 2000-ve ka mbizotëruar bindja se vet oferta e perspektivës evropiane do të jetë e mjaftueshme që ky proces të përfundoj me sukses. Më shumë se 15 vite më vonë, perspektiva evropiane, me gjithë premtimet e Selanikut të vitit 2003, është gjithnjë e më e dobët, kurse shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor (duke shtuar Kroacinë, e cila është anëtare e BE-së) gjithsesi se nuk mund të quhen të qëndrueshme dhe të stabile qëndrueshme. Edhe pse në thelb janë të përfshira në programet dhe nismat rajonale, të cilat janë të lidhura me BE-në (p.sh., CEFTA 2006, Bashkësia energjetike etj.) dhe, edhe pse në masë të madhe harmonizohen me rregullat dhe qasjet e vlerave të BE-së, edhe më tutje mund të pritet përgjigje negative në pyetjen „a do të ishte rajoni i sigurt, sikur të mos kishte ndikim BE-ja”.

Në vitin 2016, BE-ja e ka publikuar Strategjinë e re Globale, me të cilën është zëvendësuar strategjia paraprake evropiane e sigurisë e vitit 2003. Dokumenti i ri promovon një qasje të re, më aktive ndaj Bashkimit Evropian për vendet kandidatë dhe kandidatët potencial për zgjerim, si dhe fqinjësisë së drejtpërdrejtë të BE-së, duke pasur për qëllim mbështetjen për demokracinë, stabilitetin dhe paqen me qëllim që me këtë të ndihmohet ruajtja e sigurisë në vet Bashkimin Evropian përkatësisht në vendet anëtare. Koncepti, në të cilin ngulet këmbë është “fortësia” (angl. *resilience*) shtetërore dhe shoqërore, e cila është përkufizuar si „aftësi e shteteve që të reformohen, duke pasur sukses kështu që të përballojnë dhe të mëkëmben nga krizat e brendshme dhe

⁷ Autori është drejtor i hulumtimit të Fondit ISAC dhe përfaqësues i Këshillit për qeverisje inkluzive (CIG) në Serbi.

të jashtme.”⁸ Fuqizimin e fortësisë së shteteve të Ballkanit Perëndimor e komplikon fakti se të gjitha këto shtete në thelb janë shoqëri post-konfliktuale, kurse vet konflikti (në thelbin e tij) nuk ka qenë i imponuar nga jashtë. Me vet këtë, për përforcimin e fortësisë së këtyre shteteve, kyç është procesi i suksesshëm i pajtimit në rajon, i cili deri sot nuk është i kryer. Nuk mund të pritet që cilido proces dhe levë, të cilën BE-ja e ka, e të cilat bazohen në bashkëpunimin reciprok të këtyre shteteve, do të jenë të realizuara deri në fund pa pajtimin. Kurse, pa marrë konsideratat në kërkimfaljet paraprake të shtetarëve të caktuar, një shikim kalimthi i gjendjes në këto shoqëri flet se qëllimi në thelb nuk është realizuar, dhe, së këndejmi, është i nevojshëm procesi sistematik dhe gjithëpërfshirës i pajtimit, i cili do t'i vendoste bazat për marrëdhënie cilësorisht të reja midis këtyre shteteve dhe shoqërive. Në këtë kontekst, posaçërisht është e rëndësishme nisma për themelimin e komisionit ndërshtetëror për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut – KOMRA-s⁹, për të cilat angazhohet Koalicioni për KOMRA-n dhe i cili do të duhej të jepte një bazë thelbësore për tejkalimin e trashëgimisë së të kaluarës së afërt.

Çka do të ndodh nëse nuk do të ketë pajtim?

Nuancat e një të ardhmeje të tillë mund t'i shohim qysh tash në rajon. Percepticioni i tjetrit kryesisht është negativ dhe e dëmton komunikimin cilësor si dhe këmbimin midis popujve dhe shoqërive që nga përfundimi i luftërave deri më sot. Ndikimi i BE-së në perspektivat e integritetit ka bërë që elitat e evropianizuara ta pranojnë ndikimin dhe t'i bëjnë disa lëvizje të caktuara në reformat dhe në stabilizimin e shteteve të caktuara; megjithëkëtë, refuzimet janë më se të qarta dhe edhe më tutje të pranishme, para së gjithash në qarqet nacionaliste. Nga viti 2008 dhe shpërthimi i krizës botërore ekonomike, tërheqja masive e kapitalit perëndimor nga këto shtete, krahas mungesave konstante të investimeve të reja, ia kanë hapur dyert varfërisë dhe mungesës së perspektivës e pastaj rrënimin të institucioneve dhe rënies së standardeve në pothuajse çdo aspekt të funksionimit të këtyre shteteve. Shtetet e rajonit në pjesën më të madhe janë bërë „stabilitokraci”, ashtu siç profesori Florijan

⁸ *Strategjia globale e politikës së jashtme dhe të asaj të sigurisë të Bashkimit Evropian „Vizioni i përbashkët, veprimi i bashkuar: Evropa më e fortë”* (përkthim në gjuhën serbe), Ministria e punëve të jashtme të Republikës së Serbisë, Instituti për Studime Evropiane, Qendra për çështje ndërkombëtare dhe të sigurisë – fondi ISAC, 2016, f. 29, e qasshme në: <https://www.isac-fund.org/wp-content/uploads/2017/03/The-New-EU-Global-Strategy.pdf>.

⁹ Emri i plotë është *Komisioni Rajonal për Konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish RSFJ-së nga data 1 janar e vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001*. Sipas propozim Statutit, KOMRA është komisioni ndërqeveritar (organ jashtëqyqësor) që themelohet me qëllim që në periudhën prej tri vitesh të hulumtojë pretendimet mbi të gjitha krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në lidhje me luftën; që emër për emër të regjistrojë të gjitha krimet në lidhje me luftën, si ato civile, ashtu edhe luftëtarët, si dhe që të mbledhin të dhëna mbi kampet e përqendrimit dhe vendet e tjera të burgosjes.

Biber (Florian Bieber) i ka quajtur – shtete të cilat krijojnë një imazh të caktuar të stabilitetit, por në të cilat potenciali esencial për forcimin e “fortësisë” së thellë dhe afatgjate është i vogël. Kurse stabilitokracitë ushqehen, midis të tjerash, me paragjykime ndaj të tjerëve, gjë që është një nga mekanizmat për ruajtjen e pushtetit. Ka shumë shembuj nga tre dhjetëvjetëshat e fundit se si sistemi i tillë funksionon. Madje mund të konstatohet se interesat për pajtimin esencial janë tejet të kufizuara, por jo edhe joekzistuese, sikur të ekzistonte perspektiva dhe procesi zyrtar.

Sidoqoftë, “fortësia” nuk mund të ndërtohet nëse ekziston frika imagjinare prej tjetrit. Çështja e pajtimit nuk është ekskluzivisht e lidhur për elitat momentale politike, por ekziston edhe perspektiva thellësore në secilin prej shteteve. Ballkani perëndimor është i ndarë në plan etnik dhe fetar, dhe këta kufi nuk përputhen me kufijtë shtetëror. Shumë pakica ose rajone nuk janë të integruara, kurse vet shtetet, me gjithë faktin se në kufijtë e vet kanë pakica të shumta ose bazohen në një rregullim kompleks të brendshëm, në thelb nuk kanë politika të drejtuara në realizimin e integritit ndëretnik. Bashkësitë mbeten të robëruara në narrativat e vet, derisa komunikimi realizohet vetëm përmes politikanëve, të cilët janë të interesuar për ndasitë përkatësisht pjesëmarrje në pushtet. Po ata të njëjtët politikanë vijnë në pushtet pikërisht nëpërmes të manipulimeve me “frontet e hapura” të vërteta ose imagjinare midis bashkësive.

Mungesa e pajtimit në rajon dhe integrimi esenciale ndëretnike brenda vet shteteve e hapin rrugën edhe për ndikime të tjera. Ato janë, para së gjithash, ndikime në rritje të shteteve të treta të fuqishme, jashtë rajonit dhe jashtë BE-së. Këto shtete tash e disa vite me sukses e dëmtojnë imazhin e BE-së si një projekt i suksesshëm. Megjithatë, ato kryesisht nuk kanë kurrfarë vizioni afatgjatë për rajonin, por vetëm dëshirojnë të projektojnë ndikimin e tyre dhe të zgjerojnë atë në grupet e ndjeshme, të cilat mungesa e pajtimit esencial i ka lënë në gjendjen në të cilën janë. Këta akterë kanë interes, e pakta, ruajtjen e *status quo*-s, pasi që pikërisht ky iu mundëson ushtrimin e ndikimit. Kurse paqëndrueshmëritë e përhershme e mundësojnë edhe rritjen e tyre. Kështu që ekziston rreziku i përhershëm se ato shtete të treta edhe përfundimisht instrumentalizojnë ndikimin e tyre me qëllim të realizimit të interesave vetanake, që kryesisht kanë pak lidhje me rajonin. Instrumentalizimi i tillë e hap perspektivën e mëtejme të ballkanizimit të pakontrolluar dhe të konflikteve.

E vetmja masë, me të cilën mund t'i kundërvihemi perspektivës së këtillë është hapja e procesit të përbashkët politik të *pajtimit* „të gjashtëshes ballkano-perëndimor”, në të cilën gjithsesi se do të duhej të merrte pjesë edhe Kroacia, pa marrë parasysh anëtarësinë në BE. Ky proces do të duhej të përcillte proceset e parapranimit dhe nismat

rajonale siç është Procesi i Berlinit (e madje edhe të bëhet pjesë e tyre e pandashme). Konstatimi i fakteve të pakundërshtueshme mbi të kaluarën ka një rëndësi esenciale për pajtimin në rajon dhe, në këtë kuptim, do të ishte i rëndësishëm edhe iniciimi zyrtar i KOMRA-s dhe lidhja e tij me Procesin e Berlinit. Dhe në fund, procesi i pajtimit do të duhej të reflektonte në proceset e brendshme të integritit ndëretnik brenda vet shteteve të rajonit. Pa pajtim nuk ka „qëndrueshmëri” të këtij rajoni dhe askush nuk mund të llogaris në “ekzistimin” e stabilitetit dhe të sigurisë në rajon. Pajtimi fare në mënyrë të qartë nuk është edhe proces i cili është imanent për integrimin evropian, sado të jetë i afërt me te. Ai është një hap më shumë, i cili integrimin evropian e bënë në shtigje afatgjata të suksesshëm.

3

PËRSE PAJTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM NË BALLKANIN PERËNDIMOR PËR SUKSESIN E AGJENDËS EKONOMIKE TË PROCESIT TË BERLINIT?

dr Jelica Miniq¹⁰

Procesi i Berlinit gjatë katër takimeve në krye. (Berlin, Vjena, Parisi dhe Triesta) pjesën më të madhe të aktivitetit e ka fokusuar në fushën e bashkëpunimit ekonomik - janë lansuar Agjenda për lidhjen në Ballkanin Perëndimor (angl. *Connectivity Agenda*), Zona Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor 6 (angl. *Regional Economic Area in the Western Balkan Six*). Forumi i Investimeve i Odës së Ballkanit Perëndimor (angl. *Western Balkan Chamber Investment Forum*). Por qysh nga takimi i parë në Berlin, pajtimi ka qenë temë përherë e pranishme. Sepse është e paimagjinueshme të ndërtohet një agjendë rajonale ekonomike kështu ambicioze, e ajo të mos bazohet në komunikimin normal të qytetarëve, të qarqeve afariste dhe profesionale dhe të përfaqësuesve të administratave kombëtare. Realizimi i saj është i pamundshëm pa vullnetin e fortë politik të liderëve në rajon dhe pa marrjen e padyshimtë të obligimeve, të cilat rezultojnë nga deklarimi i vullnetit të tillë politik.

Kush do të shkojë nëpër gjithë ato rrugë të reja ose të rindërtuara, nëpër hekurudha, linja të lumenjve dhe detare, të cilat do t'i mbështes Procesi i Berlinit përmes agjendës së lidhjes? Kush do ta shfrytëzojë infrastrukturën digjitale dhe romingun e papagesë kur ai do të implementohet përmes planit të veprimit për integrimin digjital të rajonit në kuadër të zonës ekonomike rajonale? Kush do të punësohet lirshëm ma anë të diplomave reciprokisht të njohura kudo qoftë në rajon ku shfaqet kërkesa për fuqinë punëtore me kualifikim të lartë në kuadër të programit të mobilitetit? Kush do të studioj nëpër qendrat e akredituara rajonale të përsosmërisë? Kush do ta shes mallin aty ku është më së miri të plasohet në rajon ose të investojë në ndonjë lokacion atraktiv në të cilin e çojnë rrugët e parasë, në çka më shumë se sa një dhjetëvjetësh punon CEFTA, RCC ose jo fort moti Forumi i

¹⁰ Autorja është kryetare e Forumit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Lëvizje Evropiane në Serbi.

Investimeve i Odës i rajonit? Gjithkund janë akterët kryesor dhe shfrytëzues janë qytetarët. Të gjitha format e komunikimit punues-arsimor-afarist nënkuptojnë një nivel bazik të besimit, klima nxitëse dhe informim të mirë reciprok, që është ilaçi më i mirë kundër paragjykimëve.

Qytetarët e Ballkanit Perëndimor kanë interes që të çlirohen nga barra e rëndë e të kaluarës jo të largët në mënyrë që ekonomitë, shoqëritë, punët, familjet e tyre të mund të përparojnë. Rezultatet e mira ekonomike në dhjetëvjetëshin paraprak, kur BPV për kokë banori i është afruar mesatares në BE për 8,5 për qind, kanë rënë në një përmirësim gradual të marrëdhënieve bilaterale në rajon dhe në përparimin e klimës për pajtim dhe bashkëpunim. Me krizën botërore, e cila seriozisht e ka goditur edhe BE-në, si partner kryesor ekonomik i Ballkanit Perëndimor, për rajonin ka arritur dekada e stagnimit ekonomik dhe e tensioneve të reja në marrëdhëniet midis shteteve në rajon, që e kanë rrezikuar edhe procesin e pajtimit. Reformat e ngadalësuara, papunësia e madhe, rritja e varfërisë, rënia e cilësisë së shkollimit, shëndetësisë, mbrojtjes së fëmijëve nuk kanë ndikuar në mënyrë inkurajuese as në marrëdhëniet në rajon si dhe as në proceset e integritimit evropian.

Për këtë arsye inicimi i Procesit të Berlinit dhe orientimi i tij i fuqishëm në këndelljen ekonomike të rajonit kanë paraqitur një nxitje të madhe për këtë hapësirë, plotësisht e rrethuar me vendet anëtare të BE-së dhe të NATO-s. E gjithë ajo që ka ndodhur në ato dy organizata dhe ajo çfarë ndodh drejtpërdrejt gërshetohen në rajon. Ripërtëritja ekonomike në BE, negociatat mbi pranimin e Malit të Zi dhe Serbisë në BE, pranimi i Malit të Zi në Aleancën e NATO-s, i inkurajojnë njerëzit afarist dhe të gjithë qytetarët e tjerë që lidhjet e tyre në rajon t'i gjallërojnë dhe t'i zhvillojnë.

Procesi i Berlinit i ka bërë të dukshme rezultatet e nismave të shumta rajonale, të cilat tash e shumë vite krijojnë një ind të nevojshëm adekuat në hapësirën rajonale të Ballkanit Perëndimor –Këshillin për bashkëpunim rajonal, CEFTA, Bashkësitë energjetike, Observatori i Transportit për Evropën Juglindore, Shkollat Rajonale për Administrim Publik, Rrjetet e asociacioneve të bashkësive lokale në Evropën Juglindore etj. Projektet e tyre, në të vërtetë e kanë mundësuar që e tërë struktura e nismave më të rëndësishme të Procesit të Berlinit të vendoset ashtu shpejt dhe të koordinohet. Projektet e tyre, që e përforcojnë bashkëpunimin ekonomik rajonal, zhvillimin e afarizmit, lidhjen e infrastrukturës energjetike dhe të transportit si dhe përparimin e politikave në ato fusha, e bëjnë rajonin perspektiv me tregun e përbashkët, që është më atraktiv për investitorët e huaj dhe që i kontribuojnë përshpejtimin të integritimit të tyre evropian dhe euroatlantik,

posaçërisht në sektorët ku drejtpërdrejt inkuadrohet në agjendën e lidhjes së BE-së. Megjithëkëtë, edhe pse lidhja me BE-në është dimension i rëndësishëm i Procesit të Ballkanit, dimension i rajonal mbetet primar. Të gjitha agjendat e cekura, orientimet, projektet, nismat, para së gjithash e lidhin vet rajonin dhe i standardizojnë politikat dhe praktikën në të gjitha fushat esenciale, gjë që hap hapësirë për marrëdhënie më të mira ndërfaqinësore dhe përfshirje më të mirë në politikat evropiane makrorajonale (Strategjia e BE-së për rajonin danubian, Strategjia e BE-së për rajonin adriatiko-jonian).¹¹

Me paralajmërimin se viti 2025 është afati orientues për pranim në anëtarësinë e BE-së të atyre që në rajon do të përparojnë shpejt dhe me paralajmërimin e samitit të ri BE-së – Ballkani Perëndimor në Bullgari gjatë Kryesimit të Bullgarisë të Bashkimit Evropian në gjysmën e parë të vitit 2018- hapen binarë të shumtë të ri për gjallërimin e rajonit, që mund të lehtësojnë pajtimin. Për këtë arsye ky moment duhet të shfrytëzohet dhe të vendoset pajtimi në krye të agjendës së samitit të ardhshëm në kuadër të Procesit të Berlinit. Kjo do të thotë se në Londër duhet të nënshkruhet marrëveshja ndërshtetërore mbi themelimin e Komisionit Rajonal – KOMRA, e pastaj, përmes një serie të hapave konkret, të realizohet ai. Me kryerjen e detyrave të këtij komisioni ndërshtetëror – me konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë luftërave të viteve nëntëdhjetë, do të hiqej rreziku që manipulimi me interpretime të ndryshme të bëhet burim i tensioneve të reja. Ashtu siç gjërat janë sot, mosekzistimi i pajtueshmërisë ndërshtetërore rreth këtyre fakteve mbetet një kërcënim i heshtur për secilin lloj të bashkëpunimit dhe, së këndejmi, i vë në pyetje edhe efektet afatgjata të projekteve infrastrukturore dhe të tjera ekonomike, të iniciuara në kuadër të Procesit të Berlinit.

Në esencë, ashtu siç është edhe vet Bashkimi Evropian në thelbin e tij projekti më i suksesshëm paqësor në botë, Procesi i Berlinit është pjesë e një projekti më të gjerë paqësor për Ballkanin Perëndimor, pjesë e integritimit të asaj hapësire në BE. Ai duhet të çoj deri te “krijimi i një modeli të ri të kryerjes së punëve politike, që favorizojnë bashkëpunimin në vend se konfrontimin, diplomacinë në vend se luftën

¹¹ *Strategjia e BE-së për Rajonin e Danubit, Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatiko-jonian (EU Strategy for the Danube Region, EU Strategy for the Adriatic-Ionian Region).*

dhe fuqinë civile në vend të forcës ushtarake”.¹² E deri te kjo arrihet me anë të kultivimit të procedurave dhe të zakoneve që e mbështesin paqen, me anë të krijimit të rrjetave të konsultimit, komunikimit, tubimit të liderëve dhe të qytetarëve të rajonit dhe me vendosjen e bashkëpunimit si mënyrë e jetës, si kulturë dominuese e marrëdhënieve të ndërmjetvetshme.

12 "...krijimi i një modeli të ri të kryerjes së punëve politike, që favorizojnë bashkëpunimin në vend se konfrontimin, diplomacinë në vend se luftën dhe fuqinë civile në vend të forcës ushtarake creation of a new model for doing political business that emphasizes cooperation over confrontation, diplomacy over war, and civilian power over military power." (McCormick, J., *Përse është e rëndësishme Evropa - Rasti për Bashkimin Evropian*, Palgrave Macmillan, London, 2013, f. 30. (*Why Europe Matters - The Case for the European Union*, Palgrave Macmillan, London, 2013, f. 30.)

4

KOMRA SI KUSHT PËR BASHKËPUNIMIN EFIKAS TË TË RINJVE, QË ÇON DREJT PAJTIMIT

Sven Milekiq¹³

Me aderimin në Procesin e Berlinit në vitin 2014, vendet në Ballkanin Perëndimor janë obliguar për fuqizimin e lidhjeve reciproke. Brenda këtij procesi, pjesëmarrësit e Procesit të Berlinit i kanë kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve dhe posaçërisht bashkëpunimit midis të rinjve në rajon. Të inspiruar me përvojën e Zyrës francezo-gjermane për të rinjtë, të themeluar në vitin 1963, pjesëmarrësit e Procesit të Berlinit kanë vendosur për të mbështetur krijimin edhe të një projekti tjetër edhe më kërkues – të Zyrës Rajonale për bashkëpunim të të Rinjve të Ballkanit Perëndimor (RYCO¹⁴).

RYCO ka një mandat mjaft të gjerë të veprimit, i cili prek në fushat e arsimit, dijes, ekonomisë, kulturës, por edhe temave të cilat kanë të bëjnë me promovimin e tolerancës, të bashkëjetesës dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ashtu siç Marrëveshja mbi themelimin e RYCO-s e cek, Zyra e Ka për objektiv për të mbështetur rajonin, në të cilin të rinjtë do të kenë „vëtedije për të kaluarën “. Në gjurmët e zyrës francezo-gjermane për të rinjtë, e cila ka punuar për afrimin dhe pajtimin e të rinjve vetëm 18 vite pas Luftës së Dytë Botërore, pajtimi bëhet një postulat i rëndësishëm edhe i RYCO-s. Ky dimension i RYCO-s më tutje është thelluar gjatë Samitit në Triest, kur përmendet pajtimi si një nga tri aktivitetet themelore të Zyrës, së bashku me bashkëpunimin dhe këmbimin. Pos kësaj, pajtimi theksohet si një nga vlerat më të rëndësishme të Procesit të Berlinit që nga krijimi i tij në vitin 2014. Po ashtu, pajtimi qëndron në thelbin e projektit të Bashkimit Evropian që nga vet fillimi i tij; pajtimi i cili do të duhej të shërbente si themel i paqes afatgjate dhe të qëndrueshme pas Luftës së Dytë Botërore shkatërruese.

Ajo me të cilën Samiti i Triestes është interesant është fakti se si atje njihet rëndësia e shprehur e nismës për themelimin e komisionit rajonal, ndërshtetëror për konstatimin e fakteve - KOMRA-s¹⁵. KOMRA , si organ i cili do të duhej të shërbente për konstatimin e fakteve në lidhje me të rënët, do të vlarët, të burgosurit dhe personat e zhdukur gjatë konflikteve të armatosura, luan pikërisht rol të rëndësishëm në proceset e pajtimit në

¹³ Autori është gazetar i Balkan Investigative Reporting Network (BIRN)

¹⁴ Shkurtesa për „Regional Youth Cooperation Office“. Zyra Rajonale e Bashkëpunimit të të Rinjve

¹⁵ Emri i plotë është: Komisioni Rajonal për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish RSFJ-së nga data 1 janar e vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001.

rajon. Si organ i cili ka mandat rajonal, e vetmja KOMRA mund të dal nga përpjekja për mbledhjen e fakteve mbi konfliktet e armatosura brenda kufijve të vendeve. Me vet këtë, KOMRA do të ketë potencial më të madh për vendosjen e një numri më të madh të fakteve mbi konfliktet, të cilat janë zhvilluar midis akterëve brenda, por edhe midis vendeve. Duke marrë parasysh karakterin ndërkombëtar të konflikteve, në të vërtetë, pothuajse është e pamundur se si dhe kur një komision kombëtar mund të konstatojë të gjitha faktet mbi konfliktet, e posaçërisht mbi krimet e luftës, kur viktimat ndodhen në një vend, kurse kryerësit e mundshëm në një vend tjetër.

Në gjurmët e Procesit të Berlinit, të rinjtë duhet të jenë një komponent thelbësor i integritetit të rajonit të Ballkanit Perëndimor, përmes projekteve të përbashkëta të bashkëpunimit dhe këmbimit. Edhe pse një vëmendje e madhe i është kushtuar aspektit jopolitik të bashkëpunimit midis të rinjve, pajtimi ka rolin e një gjëje e cila duhet t'i paraprijë stabilitetit dhe lidhjes e bashkëpunimit juridik. Megjithëkëtë, me qëllim që të arrihet deri te pajtimi i të rinjve – të cilët vet nuk kanë marrë pjesë në konfliktet e luftës për shkak të të cilave duhet të arrihet deri pajtimi – duhet të krijohen disa parakushte të caktuara. Nuk mund të ketë kurrfarë pajtimi afatgjatë dhe të sigurtë në Ballkanin Perëndimor pa konstatimin e fakteve mbi konfliktet e viteve 90-të. Nuk mund të pajtohen në mes veti pjesëtarët e grupimeve të ndryshme nacionale dhe etnike nëse nuk dihet saktësisht se për çfarë pajtohen. Pikërisht ngaqë nuk kanë marrë pjesë në konfliktet e luftës ose madje edhe nuk kanë lindur gjatë tyre, të rinjtë duhet të kenë qasje përmes fakteve të besueshme në ato konflikte. Pikërisht faktet mbi konfliktet e luftës të viteve 90-të janë ato që mungojnë në rajonin e ish Jugosllavisë. Duke marrë parasysh se brenda vet vendeve nuk mund të vërtetohen faktet të cilat do të ishin të pranuar në nivel rajonal, vetëm nismat rajonale kanë potencial për sukses.

Pos për pajtimin midis të rinjve, faktet të cilat KOMRA dëshiron të konstatojë janë të rëndësishme edhe për ndryshimet eventuale në sistemet arsimore, të cilat i synojnë interpretimet shumetnike dhe/ose mononacionale të së kaluarës jo të largët. Formacionet e këtilla të arsimitit kështu kultivojnë gjeneratat e reja të vendosura sipas linjave etnike, që kanë distanca më të mëdha sociale dhe që janë të gatshme për të pranuar modelet e bazuara në ekskluzivitetin etnik. Me vet këtë, përderisa nuk ka fakte të vërtetuara, jo vetëm se nuk mund të arrihet deri te pajtimi cilësor midis të rinjve, por të rinjtë i dorëzohen shovinizmit etnik dhe, për pasojë, edhe popullizmit etnik. Kurse pikërisht radikalizmi i të rinjve, zhvillimin e të cilëve në Ballkan dëshiron ta përfundoj Procesi i Berlinit, qëndron në popullizmin etnik dhe radikalizmin fetar, që gjen një terren të frytshëm tek rinia e pakënaqur dhe e frustruar, me një klimë të helmuar politike dhe me mungesën e ekonomisë së zhvilluar. Në fund, faktet janë ato të cilat ua vështirësojnë

grupeve shoviniste dhe popullistëve nacionalist të manipulojnë me qytetarët dhe të instrumentalizojnë kontroverzat e pazgjidhura nga e Kaluara.

Pos kësaj, KOMRA mund të jetë e dobishme edhe për të rinjtë si një platformë e llojit të vet në lidhjen e tyre të mëtejme ndëretnike dhe ndërnacionale. Nismat ndëretnike dhe ndërnacionale dhe projektet e të rinjve në kuadër të RYCO-s mund të përcjellin aktivitetet e KOMRA-s së ardhshme anë e kënd rajonit. Po ashtu, në aksionet e veta publike, Koalicioni për KOMRA tashmë ka treguar se si ka potencial për të mobilizuar njerëzit e rinj, përkundër trendeve brengosëse anë e kënd rajonit, që tregojnë një distancë gjithnjë e më të madhe midis të rinjve të cilët i takojnë grupimeve të ndryshme etnike dhe nacionale¹⁶. Në këtë mënyrë, aktivitetet e të rinjve dhe të KOMRA-s së ardhshme mund të përplotësohen në mënyrë reciproke.

Duke marrë parasysh se Procesi i Berlinit e synon vendosjen e paqes së përhershme, bashkëpunimin dhe pajtimin në hapësirën e Ballkanit Perëndimor, do të duhet të ndërmerren të gjitha përpjekjet në mënyrë që të realizohen parakushtet për të njëjtën. Në këtë proces, rol të rëndësishëm luajnë të rinjtë, si gjenerata të cilat nuk janë të ngarkuara me fajin personal për konfliktet dhe krimet e kryera, por që si përfaqësues të shoqërive vetjake bartin përgjegjësinë e ballafaqimit me ato konflikte dhe krime. Me qëllim që të rinjtë të mund të ballafaqohen me krimet, atyre iu janë të nevojshme faktet, të cilat, në karakterin rajonal të atyre konflikteve, mund të konstatohen vetëm nga KOMRA. Në këtë kuptim, me qëllim që plotësisht të realizojë objektivin e ekzistimit të tij, RYCO varet nga faktet, të cilat do t'i themelojë KOMRA. Përkatësisht, themelimi i RYCO-s dhe i tërë Procesi i Berlinit nuk do të çojë deri te procesi i pajtimit, i stabilitetit dhe bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor, nëse nuk konstatohen faktet në nivel rajonal – të cilat në të vërtetë vetëm KOMRA mund t'i konstatojë.

¹⁶ Për më shumë informata, shih: <https://www.vecernji.hr/vijesti/branslava-baranovic-mladi-imagju-vrlo-negativne-stavove-prema-imigrantima-ali-i-nacionalnim-manjinama-1123682>



www.perkomra.org
www.recom.link